

Dialogu midis feve të shpallura

Prof. Dr. Ahmet Alibashiq

Rezime (përmbledhje)

Ky tekst fillon me supozimin se, për të qenë i suksesshëm dialogu ndërfeetar, nevojitet definimi i qartë i përmbajtjes së tij, si dhe veçimi i diskutimeve të vështira teologjike mbi të shpëtuarit e atyre të pluralizmit shoqëror. Në tekst dialogu definohet si një formë e komunikimit i cili ka për qëllim, që krahas dialogut dhe veprimit, të përmirësojë të kuptuarit dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit midis ithëtarëve të feve të ndryshme për hirë të bashkëjetesës në tolerancë dhe respektim të ndërsjellë. Pastaj identifikohen elementet e tij kryesore (komunikimi i qytetëruar, opinionet e ndryshme, njohja ndërmjet veti, jeta në paqe, respekti i ndërsjellë, toleranca dhe bashkëpunimi në të mirën) dhe “Platëforma për dialog e Bashkësisë Islame e Bosnjë dhe Hercegovinës”. Në fund, ofrohen një sërë shembujsh nga bashkëpunimi i të Dërguarit të Allahut, Muhamedit a.s., me jomuslimanët.

Fjalët kryesore: dialogu ndërfeetar, jomuslimanët, ehlu'l-kitab, pluralizëm, tolerancë, paqe, Platëforma për dialog e BI të BeH-së.

Feja (besimi) sipas Kur'anit është historia më e rëndësishme njerëzore. Nga botëkuptimi i perspektivës kuranore, njeriu, para së gjithash, është qenie shpirtërore e fetare. Me besim dhe nëpërmjet tij njeriu ngritet (ngjitet) dhe përcmohet deri në shkallë hyjnore të vlerave. Raporti ndaj Krijuesit, e përmes Tij edhe ndaj prindërve, vetvetes, familjes, njerëzve të tjerë dhe ndaj të gjitha krijesave të tjera të Zotit, të gjalla apo të vdekura qofshin, është masë kryesore e vlerave njerëzore. Besimi është rrugë shpëtimi për njeriun, porse në këtë rrugë janë të mundshme edhe devijimet e mëdha, gjë që historia është dëshmitari më i madh. Në luftë kundër njeriut janë shajtani, pasioni i tij, dhe jo rallë herë edhe njerëzit.

Në mënyrë që t'i ndihmojë, Zoti i premtoi njeriut ndihmë duke e udhëzuar përmes shpalljeve dhe duke i dërguar 124 mijë të dërguarë të Tij. Të rrallë ishin ata që plotësisht patën sukses. Një prej historive të tilla të rralla të suksesshme është ajo e Junusit a.s. (10:98). Nga ana tjetër, kishte prej të dërguarve të cilët nuk patën mundësi të përfitonin qoftë edhe një njeri gjatë misionit të tyre. Për më tepër, edhe atëherë kur pejgamberët e Zotit në fillim kishin sukses, porosia e monoteizmit që sillnin, dalë nga dalë dhe me kohë shtrembërohej. Muslimanët besojnë se Muhamedi, i biri i Abdullahut (571-632), a.s. është i dërguari i fundit për njerëzit nga Zoti, kurse Kur'ani është Shpallja e Tij e fundit. Kur'ani u dërgua atëherë kur të gjitha porositë e mëparshme të Zotit dërguar njerëzve u ndryshuan, ndonëse ekzistojnë gjurmë vërtetësie dhe urtësie tek verzionet e tyre të shkruara që kanë arritur deri tek ne. Pjesa më e madhe e muslimanëve besojnë se shpëtimi i vetëm është të besosh Zotin një, të besosh Muhamedin a.s., si pejgamber, Kur'anin dhe Ditën e llogarisë pas vdekjes. Madje, sipas disave, vetëm dyshimi se kjo rrugë është e vetmja për të shpëtuar është blasfemi (mosbesim). Në të vërtetë, ky nuk është i vetmi qëndrim musliman, mirëpo me siguri është dominues. Në fakt, leximi i zakonshëm, tradicioanl, i Kur'anit dhe Sunetit ofron argumente të bollshme në përkrahje të kësaj pikëpamje.

Kjo pikëpamje shpesh quhet edhe si apsolutizëm teologjik, i cili, më që ra fjala, nuk është, aspak, vetëm veçori e muslimanëve. *Shumica* e ithëtarëve tradicionalë të bashkësive të tjera fetare këtë në fakt e kanë, gjithësesi, secili duke u nisur nga vetë feja e vet. Ky pozicion mund të përmblihet kështu: vetëm ithëtarët e traditës sime fetare kanë shansin për të shpëtuar; të gjithë të tjerët janë mëkatarë të përbuzur dhe të pafe, të dënuar në zjarrin e përjetshëm. Edhe pse ky pozicion mund të jetë vetvetiu problematik, ai shndërrohet i përbuzur kur fiton epilogun

e tij negativ në këtë botë; atëherë kur kulmon me apsolutizmin ose ekskluzivizmin shoqëror. Disa përfaqësues të kësaj pikëpamje shkojnë edhe më tutje dhe thonë: Si të tillë (mëkatarë dhe të pabesë), ithëtarët e feve të tjera nuk meritojnë respektin tonë madje edhe në këtë botë. Të drejtat e tyre për jetë, pasuri, liri, etj., nuk janë të shenjta sikur që janë të bashkëfetarëve të mi. Nuk është vështirë për tu hetuar se ky pozicion disi ka qenë i zbatueshëm në botën e bashkësive fetare të izoluara apo të atyre dominuese, gjegjësisht ka qenë burim i shumë problemeve dhe përplasjeve në botën e pluralizmit global. Në bashkëveprim me ideologjitë e tjera ekskluzive, sikur nacionalizmi etnik, anti-semitizmi, madje edhe fashizmi dhe nazizmi, ai mund të shpie deri te një numër përplasjesh me pasoja tragjike në botën tonë të pluralizmit. Në një ambient të tillë, rishqyrtimi i mësimi të trashëguar, bashkëpunimi i ndërsjellë për ta kuptuar më mirë njëri tjetrin dhe ngritja e urave midis bashkësive të ndryshme fetare, është imponim i dorës së parë. Sepse, sikur që edhe kanë vërejtur, për të vazhduar të ekzistojë kjo botë e jona, paqja midis feve, jo që është e mjaftueshme, por është e domosdoshme. Edhe pse interpretimet dhe shpejgimet e reja radikale të mësimi dhe koncepteve klasike në kuptim të inkluzivizmit ose pluralizmit religjioz përbëjnë alternativën më atraktive, gjë që të gjithëve u kumton shpëtimin, përsëri një qëndrim i tillë nuk është gjithmonë real. Për shumë besimtarë tradicionalë, ndryshimet e tilla rrënjësore, cenojnë çështjet doktrinare themelore të fesë së tyre dhe si të tilla paraqesin tradhëti ndaj traditës, ose të paktën nuk janë gjithmonë bindëse. Për më tepër, kjo shkakton reaksione fundamentale, sidomos kur nevoja e njerëzimit për paqe është urgjente. Në një situatë të tillë, ajo që neve na duket shumë e rëndësishme është të theksojmë se, sidomos kur është në pyetje Islami, një apsolutizëm i butë teologjik, i cili nuk shqetëson ndërgjegjen e besimtarit tradicional, gjegjësisht nuk shkakton në të ndjenjën e tradhëtisë së vetë traditës, ka mundësi të koegzistojë në inkluzivizmin shoqëror, i cili njerëzimit do t'i garantojë jetën në paqe dhe respektin e ndërsjellë në dallime.

Dhe pikërisht kjo, pra të shpëtuarit në këtë botë nga humnera e urrejtjes, përlëshjes, dhunës dhe luftës, mirëpo jo edhe nga fati i botës tjetër, është interesi ynë primar kur flasim me njëri tjetrin. Përgjigjet që kanë të bëjnë në pyetjet të cilat ndërlidhen me fatin e botës tjetër, ne ato i kërkojmë brenda besimeve tona dhe përmes dialogut me autoritetet fetare, si dhe në librat e shenjtë. Shumë kush prej nesh interesohet se, vallë, çfarë mendojnë fqinjët tanë të besimeve të tjera fetare në lidhje me të drejtat tona në këtë botë. Shumë më pak, ose aspak, nuk na interesojnë bindjet e tyre në lidhje me atë se ç' do të ndodh me ne kur ta lëshojmë këtë botë, përderisa besimi i saj/atij nuk i nxit që të na privojnë nga liritë dhe të drejtat tona në këtë botë. Nga ky shkak, sado të rëndësishme të duken shqyrtimet për shpëtimin, mbi atë se cili është *kafir*, kush do të hyjë në Xhennet e kush në Xhehennem, e të ngjashme, konsideroj se rëndësinë e tyre për administrimin me shoqëritë multifetare nuk duhet glorifikuar. Dobitë nga ecja përpara në këto shqyrtime zakonisht janë shumëfish më të vogla nga reaksioni të cilin ata e nxisin ndër besimtarët tradicionalistë dhe dyshimin në dialog të cilën e nxisin. Për këtë arsye do të përfaqësoja ndarjen e këtij shqyrtimi dhe riinterpretimin e traditës fetare e cila mund të zgjasë me dekada e edhe me shekuj nga biseda për bashkëjetesën në paqe dhe respektin e ndërsjellë në këtë botë, sepse nuk ka arsye që vetes t'ia vështirësojmë detyrën edhe ashtu sfiduese. Pohojmë se kjo, në rastin islam, është e mundshme dhe këtë do të mundohemi ta dëshmojmë në rreshtat në vijim. Mirëpo, në radhë të parë, vlen që të njihemi me termin “dialog” dhe mënyrën se si e kuptojmë atë për nevojat e këtij punimi.

Dialogu ndërfeetar – një ide e pakuptuar

Dialogu ndërfeetar është, relativisht, një ide dhe levizje e re. Duke mos hyrë në diskutime të detajuara, mund lirisht të themi se dialogu ndërfeetar nuk është më i vjetër se një shekull, ndërkoh që është duke u zhvilluar intenzivisht gjatë këtyre pesëdhjetë viteve të fundit. Disi më shumë është intensifikuar pas koncilit të dytë të Vatikanit, në vitin 1960, kur Kisha katolike, njëra ndër organizatat fetare më të mëdha dhe më mirë të organizuara në botë, miratoi idën e dialogut. Lëvizja për dialog ndërfeetar mori jehonë të madhe, edhe përkundër

skepticizmit dhe kundërshtimit të disa grupeve, përfshirë këtu evangjelistë, katolikë konservativë, muslimanë, fundamentalistë e tjerë.[1]

Sot shumë muslimanë marrin pjesë në shumë aktivitete ndërfetare, por ka edhe të tillë të cilët janë të rezervuar dhe që e kundërshtojnë dialogun ndërfetar. Në pjesën më të madhe të rasteve konstatohet se kundërshtimi vije si pasojë e mosmarrëveshjes rreth natyrës dhe qëllimit të dialogut ndërfetar. Në fakt, shumë prej tyre frikësohen se dialogu ndërfetar është edhe një mashtrim i radhës katoliko-hebraik, i inicuar kundër fesë së vetme të drejtë islame. Andaj, për këtë shkak, është shumë e rëndësishme që të qartësohet se çfarë në të vërtetë është dialogu ndërfetar dhe çfarë nuk është.

Natyrisht, nuk ka vetëm një kuptim të vetëm të dialogut ndërfetar dhe të qëllimeve të tij, mirëpo ne besojmë se shprehim mendimin e shumë pjesëmarrësve të tjerë aktiv në të, kur atë e definojmë si *“një formë e komunikimit i cili ka për qëllim, që krahas dialogut dhe veprimit, të përmirësojë të kuptuarit dhe ngritjen e urave të bashkëpunimit midis ithëtarëve të feve të ndryshme për hirë të bashkëjetesës në tolerancë dhe të respektit të ndërsjellë.”* Qëllimi, pra, nuk është zhdukja e dallimeve në të menduar dhe të besuar, por që dallimet të kuptohen dhe të pranohen ashtu siç janë. Respekti dhe angazhimi pozitiv nuk donë të thotë që dallimet në doktrinë dhe në interpretim janë të parëndësishme. Kjo vetëm donë të thotë se, rreth dallimeve të tilla, duhet diskutuar lirshëm dhe hapur. Të dialogosh donë të thotë të kuptosh dhe të bësh diç për të tjerët, e jo t'i triumfosh dhe t'i heshtësh.[2] Platëforma për dialog e Bashkësisë Islame e Bosnjës në këtë kuptim, thotë: *“Në dialogun ndërfetar duhet që të respektohen të drejtat e të tjerëve, të shmangen dabatet negative mbi të tjerët dhe të afirmohen vlerat e tolerancës dhe praktikës së bashkëjetesës fqinjësore në BeH.”*

Dialogu ndërfetar nuk ka për qëllim që t'i bashkojë të gjitha fetë ose prej tyre të formojë një fe qytetare me besime, rituale dhe lutje të përbashkëta. Bashkësia Islame në Bosnjë, në platëformën e saj për dialog, qartë ka shprehur rezerva sa u përket lutjeve të përbashkëta, madje në këtë çështje nuk është e vetmja. Në të thuhet: *“B.I. konsideron se ... nuk ka nevojë që të organizohen lutje të përbashkëta të ithëtarëve të feve të ndryshme, për shkak se çështjet e tilla janë të karakterit doktrinar dhe fetar, e jo shkencor apo dialogues.”*

Gjithashtu, dialogu ndërfetar nuk është thirrje (*da've*), gjegjësisht mision. Ai nuk e eliminon misionin, por as nuk e zëvendëson atë. Ai ka gjasa, por edhe nuk është patjetër, t'i krijojë kushtet për *da'ven*. Dialogu ndërfetar, gjithashtu, nuk është dhe nuk guxon të jetë i karakterit të debatit polemik, logjik apo teologjik, që ka për qëllim triumfin ndaj kundërshtarit në konkurim. Polemikët janë legjitime, mirëpo ato nuk janë më dialog, por diçka tjetër. Dialogu ndërfetar nuk është as ekumenizëm, respektivisht dialog midis të krishterëve, por ky mund të bëhet si nxitje për muslimanët për një dialog ndër-musliman, sipas shembullit të atij midis të krishterëve, të cilët, kryesisht, kanë mësuar se si në mënyrë të njerëzishme të sillen ndaj dallimeve midis tyre. Dialogu ndërfetar, i kuptuar në këtë formë, pra nuk është zgjidhje për të gjitha problemet botërore, as edhe për ato boshnjake (shqiptare, M. A.), mirëpo është hap i rëndësishëm dhe i nevojshëm për ruajtjen e mirëqenies dhe të kohezionit shoqëror.[3]

Dobitë dhe përfitimet nga dialogu janë të shumta, sidomos kur janë në pyetje mbrojtja e të drejtave të pakicave, dekonstrukcioni i stereotipeve negative dhe paragjykimet e gabuara, si dhe pengimi i radikalizmit fetar. Ka shumë shkaqe se pse ndryshoi raporti i Europës dhe Amerikës ndaj hebrenjve pas Luftës së Dytë botërore, kurse njëri prej tyre, gjithsesi, është edhe pjesëmarrja aktive e hebrenjve në dialogun ndërfetar.[4] Dialogu, gjithashtu, mund të na nxiste që më mirë t'i kuptonim dhe t'i arsyetonim bindjet tona individuale. Të shumta janë pyetjet që i parashtrijnë bashkëbiseduesit në dialog, sa që mund t'i shohim si dhuratën më të mirë që mund ta fitojmë prej tyre.

Elementet e dialogut ndërfetar në Islam

Më lartë pamë se elementet kryesore të definicionit mbi dialogun janë: komunikimi i qytetëruar, opinionet e ndryshme, njohja ndërmjet veti, jeta në paqe, respekti i ndërsjellë, toleranca dhe bashkëpunimi në të mirën. Shkurtimisht do të bëjmë një qasje ndaj tretmanit kuranor që u bën secilit nga këto elemente. Njihen mirë thirrjet e shumta kuranore për një komunikim të qytetëruar me ithtarët e feve të tjera, ndërsa ne do të përmendim vetëm një prej tyre: *“Ti (Muhammed) thirr për në rrugën e Zotit tënd me urtësi e këshillë të mirë dhe polemizo me ata (kundërshtarët) me atë mënyrë që është më e mira.”* (16:125). Shkurt thënë, fjala e bukur është detyrë e çdo muslimani ndaj të gjithëve, duke i përfshirë edhe jomuslimanët.

Supozimi fillestar i dialogut është bindja se larmia dhe shumësia e rrugëve shpirtërore, deri tek e vërteta, janë me origjinë hyjnore.[5] Mësimi mbi të tjerët dhe veçanëtitë e tyre, si një shprehje e vullnetit të Zotit, duhet të jetë në qendër të dialogut. Të kuptuarit e këtillë, për Islamin, nuk është një gjë e huaj. Islami njeh shumësinë (pluralitetin) e feve dhe fton muslimanët që të respektojnë faktin të cilin e paraqet Kur’ani si një vullnet të Zotit që nuk lejohet të ndryshohet me dhunë: Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i besonin çka janë në tokë që të gjithë. A ti do t’i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë.” (10:99. Shih edhe 5:48.) Platforma e B. I. në BeH, në lidhje me dialogun, në paragrafin e saj të parë, konstaton: *“Duke filluar nga konstituimi dhe interpretimi i traditës muslimane, në fenë dhe përvojën e tyre, që nga koha e Muhamedit a.s., deri më sot, janë të njohura të drejtat e të tjerëve për lirinë e besimit dhe manifestimin e fesë. Këtë të drejtë ua jep vetë Zot i Lartmadhërishtëm, dhe është njëra prej vlerave të mbrojtura me Sheriat, ndërsa është aplikuar varësisht rrethanave shoqërore dhe historike ku muslimanët kanë jetuar me të tjerët. Bashkësia Islame (BI), pajtohet që, e drejta e lirisë së besimit dhe manifestimi i fesë, të respektohet në tërë teritorin e Bosnjë dhe Hercegovinës (BeH).”*

Në Kur’an, të njohurit, të kuptuarit dhe ndërtimi i marrëdhënieve (*te’aruf*), theksohen si shkaqe të ndarjes së njerëzimit në popuj e fise: *“O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete, , e s’ka dyshim se te All-llahu më i ndershmi ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijjat), e All-llahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë.”* (49:13). Aktivitetet arsimore ndërfetare, takimet ndërfetare dhe bashkëpunimi në programe sociale, kanë për qëllim njohjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve.

Kur flasim për paqen, si një qëllim i dialogut ndërfetar, kujtojmë se vetë misioni profetik ishte kryesisht paqësor dhe insistonte që të mbillte paqen te njerëzit dhe midis tyre. I Dërguari, Muhamedi a.s., ishte ndërtuesi i paqes në Meke edhe para peygamberisë, dhe në veçanti pas saj. Fillimisht, Medina, para së gjithash, e pranoi atë si një paqësor, e vetëm një pjesë e saj e pranuan si peygamber. Sa herë që i jepej rasti dhe mundësia, nënshkruante marrëveshje paqësore, madje edhe atëherë kur shokët e kundërshtonin, sikur që ndodhi me marrëveshjen e Hudejbijes. Sepse, edhe pse kanë të drejtë muslimanët, të cilët besojnë se është detyrë e çdo muslimani të ftojë njerëzit në Islam, është e qartë se fjala e Zotit duhet të përhapet vetëm me dëshirë e jo përmes forcës, dhe vetëm përmes paqes dhe dashurisë mund të arrihet sukcesi, e assesi në një atmosferë frike, mosbesimi dhe dhune. Prandaj dhe i Dërguari a.s., u fliste shokëve të tij që të mos e dëshirojnë luftën. Qetësia, zgjidhja e konflikteve dhe rindërtimi i marrëdhënieve (*islah* dhe *sulh*) janë të lidhura ngushtë në përpjekjet dialoguese për të jetuar në paqe dhe në raporte të mira, si dhe për t’i kapërcyer mosmarrëveshtjet e tjera, etnike, racore, etj. Kjo, pra, është edhe një prej temave të shpeshta të Kur’anit: *“Në shumë biseda të tyre të fshehta nuk ka kurrfarë dobie, përveç (bisedës) kush këshillon për lëmoshë, për ndonjë të mirë ose pajtim mes njerëzve. E kush i bën këto duke pasur për qëllim vetëm kënaqësinë e All-llahut, Ne do ti japim më vonë (në botën tjetër) shpërblim të madh.”* (4:114). Platforma e BI në BeH, në lidhje me këtë, thotë: *“BI e BeH pajtohet për paqen në botë dhe për zgjidhjen e të gjitha mosmarrëveshjeve midis shteteve përmes rrugës paqësore. Duke u nisur prej qëndrimit islam*

se të gjithë njerëzit formojnë një bashkësi, BI me vendosmëri gjykon çdo agresion, hegjemoni dhe shfrytëzim të të varfërve nga ana të fuqishmëve.”

Më tutje, nëse flasim mbi respektin ndaj besimeve të huaja, një sërë tekstesh kuranore dhe veprimesh profetike, janë thirrje e qartë në këtë drejtim. Sipas principit të reciprocitetit, Kur’ani ndalon qartë fyerjen e kulteve fetare të jomuslimanëve: *“Ju mos ua shani ata (zota) që u luten (idhujtarët), pos All-llahut, e (si hakmarrje) të fyejnë All-llahun nga armiqësia, duke mos ditur (për madhërinë e Tij). Kështu Ne ia kemi zbukuruar çdo populli veprimin e vet, mandej e ardhmja e tyre është te Zoti i tyre, e Ai i shpërblen për atë që vepruan.”* (6:108). Në këtë frymë, edhe Platforma e BI, pohon me sa vijon: “BI konsideron se çdo bashkësi dhe kishë duhet t’i gjykojë dhe sanksionojë individët apo grupet e rradhëve të tyre, të cilët përhapin urrejtjen fetare, diskutimet e dëmshme dhe nënçmimin e besimit të të tjerëve ose që nxisin jotolerancën dhe pamaturinë ndaj ithtarëve të feve dhe besimeve të tjera.” Të gjithë vendet e kultit janë objekt mbrojtjeje dhe kujdesi nga Zoti përmes njerëzve: *“... E sikur All-llahu të mos i zbrapste disa me disa të tjerë, do të rrënoheshin manastiret, kishat, havrat e edhe xhamitë që në to përmendet shumë emri i All-llahut.”* (22:40). Kur’ani dhe i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., ndaj jomuslimanëve, kryesisht, demonstrojnë mirëkuptim, dhembëshuri dhe kujdes. Sa për ilustrim, Pejgamberi a.s., është lutur për pabesimtarët (Omerin dhe Ebu Xhehlin, për banorët e Taifit, Meken e cila u godit nga thatësia) dhe u ngrit në këmbë gjatë përcjelljes së xhenazes së një gruaje hebreje. Për shkak të shqetësimit që kishte për fatin e atyre të cilët nuk i përgjegjeshin thirrjes së tij, shpesh i rëndohej gjendja, andaj dhe Zoti i Madh e pyet: *“A thua ti do ta shkatërrosh veten nga hidhërimi pas tyre, nëse ata nuk i besojnë këtij ligjërimi (Kur’anit).”* (18:6). Kur Kur’ani flet në lidhje me debatin me jomuslimanët që janë këmbëgulës, në fund kërkon prej tyre që të dëshmojnë (për besimtarët) se janë muslimanë.(3:64). Atyre iu përketë feja e tyre, kurse muslimanëve Islami: *“Ju keni fenë tuaj (që i përmbaheni), e unë kam fenë time (që i përmbahem)!”* (109:6).

Kur’ani, në mënyrë të hapur, fton të gjithë të bashkëpunojnë (*te’avun*) në punë të mira: *“...Urrejtja ndaj një populli, që iu pat penguar nga xhamia e shenjtë, të mos ju shtyjë të silleni në mënyrë të padrejtë kundër tyre. Ndhimohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e armiqësi. Kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.”* (5:2) Kësisoj, i Dërguari i Allahut, s.a.v.s., edhe para se të pranonte shpalljen, pati marrë pjesë në iniciativën *Bashkimi për vrytitin (Hilfu-l-fudul)*, qëllimi i së cilës ishte mbrojtja e të pafuqishmëve, ashtu që, më vonë, të ndihej krenar për një përvojë të tillë tek po u tregonte shokëve, dhe për gadishmërinë e tij për t’iu përgjigjur sërish ftesës nëse do të ftohej për një iniciativë të ngjashme. Për më tepër, Zoti prej nesh pret që, dallimet në besim, të jenë shkak për nxitje në garë për punë të mira (*istebiku l-hajrat*), e jo në punë të këqija dhe vrasje: *“Sikur të donte All-llahu, do t’ju bënte një popull (në fe e shariat), por deshi t’ju sprovtojë në atë që ua dha juve, andaj ju (besimtarë) përpiquini për punë të mira. Kthimi i të gjithë juve është te All-llahu, e Ai do t’ju njoftojë me atë që kundërshtoheshit.”* (5: 48)

Kjo duhet bërë në atë mënyrë ashtu sikur përkatësitë nacioanle të ndryshme motivojnë olimpistët dhe sportistët e tjerë të arrijnë në rezultate të mrekullueshme sportive. Dallueshmëria fetare është një test i cili duhet të kalohet. Është disi e habitshme por Zoti thotë se dallimet në besim sikur na kanë “zbukuruar”, ashtu që në emër të tyre të mund të bëjmë edhe më shumë vepra të mira. Nuk e di përvojën e lexuesve, por unë frymëzimin më të madh shpirtëror e kam pasur kur jetoja në mjedisin joislam të Armatës popullore Jugosllave. Kjo ishte për mua një nxitje shtesë për të dëshmuar fenë time në një mjedis ateizmi.

Gjithsesi, duhet t’ju bëhet një koncesion edhe skeptikëve: dialogu nuk është një proces i lehtë. Nuk kanë të gjithë njerëzit qëllime të mira, mirëpo, falë Zotit, nuk janë të shumtë. Për ata që janë me tjetër disponim ekzistojnë mekanizma të tjerë të interaksionit sikur që janë bisedimet, debatet, shmangiet dhe shpërfilljet. [6] Kur’ani besimtarët i mëson kështu: *“Ithtarët e librit mos i polemizoni ndryshe (kurr i thirrni në fenë tuaj) vetëm ashtu si është më së miri,*

përveç atyre që janë mizorë dhe thuajuni: “Ne i besuam asaj që na u zbrit neve dhe që u zbriti juve dhe se Zoti ynë dhe Zoti juaj është një, dhe se ne i jemi dorëzuar Atij.” (29: 46).

Dialogu është një aktivitet i cili ka kuptim vetëm kur partnerët janë të barabartë; të barabartë edhe në qëllimet e sinqerta, për shkak se, për dialogun dhe paqen, nevojiten të dyja. Platforma e BI të BeH, në lidhje me këtë, thotë: “BI nuk është e gatshme ta udhëheq dialogun me bashkësitë dhe individët, të cilët fyejnë dhe nënçmojnë mësimin islam.” Ky qëndrim është në përputhje me udhëzimet kuranore: “*Kur sheh ata se janë thelluar (me tallje) në çështjet Tona, largohu prej tyre derisa të kalojnë në bisedë tjetër. Nëse djalli të bën të harrosh (e rri me ta), pasi të bie ndër mend, mos rri me popullin mizor.*” Ose ajeti tjetër: “*Juve u është shpallur në librin (Kur’anin) që, kur të dëgjoni se po mohohet Kur’ani i All-llahut dhe po bëhet tallje me të, mos rrini me ata derisa të mos hyjnë në bisedë tjetër. Përndryshe, ju do të jeni si ata. All-llahu do t’i tubojë tradhëtarët dhe jobesimtarët që të gjithë në xhehennem.*” (4:140).

Sigurisht se gabohet nëse mendohet se këto ajete e dënojnë dialogun ndërfaqësor, sikur që e definuam më lartë, sepse është e qartë se përçmimi i çdo lloji të kulteve fetare nuk është në frymën e dialogut të përshkruar më lartë. Më tutje, në Platformë thuhet: Bashkësia islame, në marrëdhëniet e saja me ithtarët e bashkësive të tjera fetare ndjek mësimin kuranor për një jetë në paqe, drejtësi dhe mirësi me të gjithë njerëzit e vullnetit të mirë: “*All-llahu nuk ju ndalon të bëni mirë dhe të mbani drejtësi me ata që nuk ju luftuan për shkak të fesë, e as nuk ju dëbuan prej shtëpive tuaja; All-llahu i do ata që mbajnë drejtësinë. All-llahu ua ndalon t’u afroheni vetëm atyre që ju luftuan për shkak të fesë, që ju nxorën prej shtëpive tuaja dhe që ndihmuan dëbimin tuaj; ju ndalon të miqësoheni me ta. Kush miqësohet me ta, të tillët janë dëmtues të vetvetes.*” (60: 8-9) Ky është paragrafi qëndror kuranor sa i përket vendit të tjetrit në Islam. Juristi me famë i medh’hebit malikij, Shihabuddin El-Kerafi, duke i komentuar fjalët “*të bëni mirë*”, ka numëruar disa gjëra: “Dashamirësinë ndaj të dobët të tyre, plotësimin e nevojave të të varfërit prej tyre, ushqimin e të urritur prej tyre, të veshurit e lakuriqit prej tyre dhe butësinë gjatë bisedimit me to, duke e bërë këtë nga konsiderata dhe mëshira për to, e jo për shkak të frikës dhe nënçmimit, (...) edhe lutja e Zotit që t’i udhëzojë dhe t’i bëjë të lumtur, si dhe t’i këshillojmë në të gjitha çështjet, të fesë ose të kësaj bote qofshin, gjithashtu nuk duhet t’i përgojojmë, dhe se duhet t’ua ruajmë pasurinë, familjen, nderin dhe të gjitha të drejtat dhe intereset e tyre. T’u ndihmojmë edhe në rregullimin e padrejtësive të bëra ndaj tyre, si dhe në realizimin e të gjithë të drejtave të tyre...”[7] Sipas kësaj, është vendimtare që të mos bihet në sprovë që bashkësitë fetare dhe sjelljet e tyre të gjeneralizohen. Kur’ani, si për shembull, i kritikon disa të krishterë, por edhe i lavdëron disa të tjerë: “*Ju jeni populli më i dobishëm, i ardhur për të mirën e njerëzve, të urdhëroni për mirë, të ndaloni nga veprat e këqija dhe të besoni në All-llahun. E sikur ithtarët e librit të besonin drejt, do të ishte shumë më e mirë për ta. Disa prej tyre janë besimtarë, po shumica e tyre janë larg rrugës së Zotit.*” (3:110). Më tutje, Kur’ani për dy besimtarë tradicionalë lë të hapur derën e shpëtimit, për hebrenjtë dhe sebejët: “*Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, krishterët, sabejët (kishin lëshuar fenë e adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) All-llahun, dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre. Për ta nuk ka frikë as nuk kanë përse të pikëllohen (pasi që besuan All-llahun, librat, të dërguarit në mesin e të cilëve edhe Muhamedin).*” (2:62). Për shkak të krejt kësaj, duhet që përmes arsimimit dhe trajnimit të fitojmë aftësinë për të udhëhequr dialogun, që ndryshe quhet kompetencë dialoguese.

Shumë muslimanë janë kundërshtarë të hapur të dialogut për shkak të mënyrës sesi i kuptojnë disa tekste të caktuara islame. Kështu që disa prej tyre do të ftojnë mbi bazën e ajetit kuranor: “*As jehuditë, e as krishterët kurrë nuk do të jenë të kënaqur me ty deri sa ta pasosh fenë e tyre.*” (2:120). Megjithatë, e qartë është se ky ajet nuk e ndalon dialogun, porse flet mbi të qenit i kënaqur plotësisht. E nëse është fjala për këtë, atëherë njëjtë mund të thuhet se as muslimanët nuk do të jenë plotësisht të kënaqur me jomuslimanët, përderisa nuk e pranojnë Islamin. Ne këtu nuk kërkojmë kënaqësinë e plotë, por kërkojmë bashkëjetesën në paqe dhe tolerancë. Ka edhe shumë shembuj të tjerë të leximit selektiv të Kur’anit dhe të traditës së

Pejgamberit a.s. Prandaj, duhet pohuar sërish se Kur'ani, si një libër unik që është, ka edhe strukturën e tij unike. Në të gjenden shpesh, pranë njëra-tjetrës, udhëzimet e luftës dhe dispozitat e përgjithshme ligjore (kushtetuese). Kështu që, nevoja për një qasje tematike të burimeve islame shfaqet edhe më e theksuar. Për fat të keq, qasja selektive është më e lehtë dhe shpesh më e suksesshme në bindjen e njerëzve, të cilët, në të kuptuarit e teksteve, janë të mbyllur dhe sipërfaqësor, por edhe për të përfituar më lehtë vëmendjen e publikut dhe të medimeve. Vështirë se dikush do të dëgjonte kur do të përmendnit paqen dhe bashkëjetesën, ndërkohë që, po të përmendni fjalët “urre” dhe “vrit”, do të mbuloheshit nga lajmet më bombastike.[8]

“Ithtarët e Librit”

Në kontekst të bisedimit dhe dialogut, kjo na shpie te një grup i veçantë i jomuslimanëve. Në fakt, në Kur'an, vend të posaçëm midis jomuslimanëve kanë edhe hebrenjtë dhe të krishterët, të cilët krahas muslimanëve, përbëjnë “bashkësinë e ithtarëve të librit” (*ehlu'l-kitab*), si një bashkësi e ithtarëve të monoteizmit dhe *dekalogut* (dhjetë porosive) (3: 64). Kur'ani qartë thekson se Islami është vazhdimësi e fesë së Ibrahimit / Abrahamit: “*Ai ju përcaktoi juve për fé atë që ia pat përcaktuar Nuhut dhe atë që Ne ta shpallëm ty dhe atë me çka e patëm porositur Ibrahimin, Musain dhe Isain. (I porositëm) Ta praktikoni fenë e drejtë e mos u përçani në të.*” (42: 13) ose ajeti: “*Pastaj, ty të shpallëm: “Ndiqe fenë e drejtë të Ibrahimit, se ai nuk ka qenë nga idhujtarët.*” (16:123). Këtë veçori e vë në pah edhe Platforma e BI e BeH: “BI është e hapur në dialogun ndërfaqësor, sidomos me përfaqësuesit e feve monoteiste: me krishterimin (përfshirë ortodoksët, katolikët dhe protestantët) dhe me judaizmin.”

Kur'ani flet për rënie të moralit te grupeve fetare të mëparshme, sikur që flet edhe për ata të bashkësisë së Muhamedit a.s., por edhe për guximin dhe trimërinë e muslimanëve, duke u treguar shembuj pozitivë nga historia fetare e hebrenjëve dhe të krishterëve të më parshëm.[9] Kur'ani, drejtë për drejtë i fton hebrenjtë dhe të krishterët, që të mblidhen rreth një fjale dhe aktiviteti të përbashkët: “*Thuaju (o i dërguar): “O ithtarë të librit (Tevrat e Inxhil), ejani (të bashkohemi) te një fjalë që është e njëjtë (e drejtë) mes nesh dhe mes jush: Të mos adhurojmë, pos All-llahut, të mos ia bëjmë Atij asnjë send shok, të mos e konsiderojmë njëri - tjetrin zotër pos All-llahut”! E në qoftë se ata refuzojnë, ju thoni: “Dëshmoni pra, se ne jemi muslimanë (besuam një Zot)” (3:64). Pejgamberi i Allahut, Muhamedi a.s., siç do të shohim më vonë, shprehu keqardhje kur të krishterët bizantinë pësuan humbje nga ana e zjarëputistëve persianë (30: 1-6), ndërsa kur muslimanët patën nevojë më së shumti për përkrahje, ndihmën e gjetën prej një të krishteri. Me hebrenjtë, mirëpo jo edhe me arabët e tij politeistë, formuan besëlidhjen qytetare, përmes së cilës obligohej mbrojtja e ndërsjellë e qytetit të përbashkët, ndërsa këtë bashkësi të re hebraiko-muslimane e emëroi me shprehjen *Ummet* – bashkësi e veçantë krahas njerëzve të tjerë. Muslimanëve u është lejuar ushqimi i përgatitur nga ana e hebrenjëve dhe të krishterëve, kurse, në princip, u lejohet edhe të martohen me gratë besimtare të krishtera dhe hebreje: “*Sot u lejuan për ju ushqimet e mira, edhe ushqimet (të therrurat) e ithtarëve të librit janë të lejuara (hallall) për ju, edhe ushqimet (të therrurat) tuaja janë të lejuara për ta (u janë lejuar). Gratë e ndershme besimtare dhe (gra) të ndershme nga ata të cilëve u është dhënë libri para jush, kur atyre u jepni pjesën e caktuar të kurorës, por duke pasur për qëllim martesën, e jo imoralitetin dhe jo si dashnore ilegale. E kush mohon (tradhton) besimin, ai ka asgjësuar veprën e vet dhe ai në botën tjetër është prej të shkatërruarve.*” (5: 5). Sot e kësaj dite, shumë muslimanë në Perëndim shfrytëzojnë shportën hebraike të ushqimeve, në mungesë të ushqimeve hallall të çertifikuara. Kjo, gjithsesi, ka të bëjë me traditën e respektimit dhe të mbrojtjes së atij i cili konsumon ushqimin tuaj. [10]*

Jomsulimanët në jetën e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s.

Më lejoni tani të përkujtoj përkushitmin praktik të bashkëjetesës në Islam, si dhe mirëkuptimin dhe bashkëpunimit ndërfitar nëpërmjet shembujve nga jeta e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s. E bëj këtë, sepse për fat të keq, nëpër media më shumë dëgjojmë për konfliktet midis feve se sa për bashkëpunimin midis tyre; sepse raportet e përditshme për dhunën në emër të Islamit dhe muslimanëve, si dhe në lidhje me ta, ndikon tek të gjithë ne dhe në pasqyrën e cila na paraqitet mbi Islamin. Në të njëjtën mënyrë retorika e ndërsyer, në lidhje me natyrën multietnike dhe multifetare të këtij vendi, ka bërë që shumica ta vënë në dyshim bashkëjetesën këtu. Gati se të gjithë neve kjo retorikë na ka bindur në vërtetësinë e saj, pavarsisht faktit se bashkëjetesa në këtë vend me shekuj është zhvilluar në mënyrë spontane, ndërsa njerëzit dhe bashkësitë këtu në dekadat e fundit janë ndarë me dhunë. Andaj, dëshiroj ta përkujtoj audiencën (mbledhjen) e nderuar në disa shembuj të bashkëpunimit fetarë të Muhamedit a.s. dhe kështu ta forcojmë besimin e të gjithë neve për bashkëpunim dhe bashkëjetesë.

Sipas burimeve historike islame, kur Zoti i Madhërisëm e zgjodhi Muhamedin a.s. si të dërguar për njerëzit, ai këtë nuk pati mundësi ta pranojë me shumë lehtësi. U frikësua dhe u hutua. Pas ballafaqimit me melekun Xhebrail (engjëllin Gabriel), për një kohë të shkurtër ai dyshoi në veten dhe mendjen e tij. Në këto momente dramatike e ngushëllonin dy persona: gruaja e tij Hatixhja dhe një i moshuar i krishter i devotshëm, Vereka ibn Neufel. Vereka ishte nga të rallët në Mekë dhe rrethinën e saj që ishte konvertuar në krishterizëm.[11] Muhamedin a.s. tek shtëpia e tij e dërgoi gruaja e tij, Hatixheja r.a., e cila ishte kushërireja e Verekës. Si një njohës i mirë i traditës fetare ibrahimiane, dhe rolit të pejgmaberëve në atë traditë, Vereka e qetësoi Muhamedin a.s. duke i thënë se në momente të njëjta të jetës së tij ka kaluar edhe Musai / Mojsiu. Kështu pra, misioni profetik i Muhamedit a.s. filloi gjatë një takimi me një të krishter.

Pesë apo gjashtë vjetë më vonë, kur pozita e bashkësisë së vogël muslimane në Mekë, e cila nuk i nurmonte as njëqind besimtarë, u bë e padurueshme, Islami dhe muslimanët përsëri u dërguan tek të krishterët . I dërguari Muhamed a.s. vendosi që ithtarët e tij më të dobët, të cilët nuk mund t'i mbronte nga torturat e bashkëkombëasve të tij, t'i dërgoj në Abesini, respektivisht në Etiopi. Duke i dërguar në një rrugë të gjatë dhe të pasigurt, u tha: Nëse shkoni në tokën e abesinasve atje do të gjeni një mbret i cili askujt nuk i bën padrejtësi. Ai është vendi i të sinqeritetit..."[12]. Në fund numri i emigrantëve musliman arriti numrin 100, rreth tetëdhjetë bura dhe njëzet gra. Mes tyre ishte edhe vajza e Pejgamberit a.s., Rukkija dhe burri i saj, Othman Ibn Affani, i cili më vonë u bë kalifi i tretë i muslimanëve. Mikëpritja të cilën muslimanët e gjetën tek mbreti i Abisinisë, Nexhasiu, sipas të gjitha burimeve që i kemi në dispozicion, ishte fantastike. Vetë mbreti u vu në mbrojtje të muslimanëve, sidomos pasi që paria idhujtare mekase dërguan një delegacion për t'i kthyer muslimanët prapa. Bashkëpunimi muslimano-kristian, i cili filloi me dërgimin e gjashtëmbëdhjet muslimanëve të herëshëm, ka zgjatur afër një mijë vjet. Çlirimtarët musliman, rregullisht, kanë kapërcyer Etiopinë dhe nga të krishterët e atjeshëm nuk kanë kërkuar pagesën e taksave të zakonshme (xhizje) ndaj shtetit musliman.

Mes aleatëve më të fuqishëm të Muhamedit a.s dhe muslimanëve ishin edhe dy pabesimtarë, dy axhallarët e të Dërguarit të Allahut s.a.v.s: Abbasi dhe Ebu Talibi. Njëri në fund pranoi Islamin, ndërsa tjetri jo. Mirëpo, kjo nuk e pengoi të Dërguarin që ta marr me vete Abbasin, ndoshta edhe në mbledhjet dhe marërvëshjet më të rëndësishme por edhe sekrete të tij, siç ishte takimi me të konvertuarit e hershëm nga qyteti i Medinës, ku edhe planifikonte të emigroj. Kurse Ebu Talibi i ofroi përkrahjen e tij deri në frymën e fundit, përfshirë këtu edhe qëndrimin e tij me muslimanët gjatë izolimit të tyre në kodrat e Mekës, ku kaluan vështirësitë më të mëdha. Në ato kushte johumane edhe vdiq bashkë me gruan e Muhamedit a.s., Hatxihen r.a..[13]

Në vitin më të rëndë të misionit të tij, Muhamedi a.s. kaloi edhe nëpër një sprovë tjetër e cila do ta dërgojë tek një i krishter tjetër. Duke e kuptuar se nuk ka se çfarë të kërkoj në qytetin e lindjes së tij, vendosi që fatin ta provoj në qytetin fqinjë të Taifit, dhe në vend të dritës në fund të tunelit e pritën gurëzit. Derisa sa lëshonte qytetin me këmbë të përgjakura u strehua tek një kopsh me rrush që ishte pronë e dy pasanikëve të atij qyteti. Kur e panë të plagosur e thirrën robin e tyre Addasin, përndryshe i krishter, të sillte pak rrush. Gjatë dhënies së rrushit Addasi u lëshua në bisedë të këndshme me të Dërguarin e Zotit dhe shumë shpejt zbuloi elementet e përbashkëta mes Islamit dhe Krishterimit.[14]

Kur e kishte lëshuar Taifin dhe duheshte të kthehej në Mekë, Muhamedi a.s u gjend para një sprove tjetër. I duheshte, thënë sipas fjalorit modern, një vizë hyrëse për në qytetin e tij të lindjes. Asnjë nga pabesimtarët nuk dëshironte t'i jap, ndërsa besimtarët nuk kishin mundësi. Dhe, në atë moment, paraqitet një pabesimtar me zemër humane Mut'im ibn Adijj, dhe bashkë me djemtë e tij e morrën nën mbrojtje Muahmedin a.s. I Dërguari i Zotit këtë asnjëherë nuk ia harroi. Dhe derisa me shokët e tij bisedonte për fatin e 70 robërve të zënë në luftën e parë me pabesimtarët dhe të fituar nga ai, në një moment tha: Nëse Mut'imi do të ishte gjallë dhe do të më kërkonte që t'i liroja të gjithë, unë do ta bëja një gjë të tillë. Ishin ato momente triumfi mirëpo edhe momente më se të nevojshme ku bashkësisë së re muslimane, të cilën një pjesë të madhe e përbënin emigrantët e ardhur nga Meka, ishte tepër e mirëpritur shuma që Mekasit ishin të gatshëm të paguanin për lirim të afërmëve të tyre.[15] Në momente të tilla, Muhamedi a.s., ishte i gatshëm ta falënderoj një pabesimtar që vetëm njëherë i kishte ndihmuar.

Tanimë e përmendëm se gjatë trembëdhjetë vjetëve të misionit në Mekë, Muhamedi a.s. dhe ithtarët e tij përjetuan momente shumë të vështira. Kaluan shumë vuajtje, vrasje e keqtrajtime. Megjithatë, kur vendin e kaploi thatësia dhe urria, njëri prej liderëve të Mekës, Ebu Sufjani, i kërkoi Muhamedit a.s që ta lus Zotin të lëshoj shi dhe ai pa hezitim e bëri këtë.[16]

Dhe derisa në qytetin e vogël arab, në Mekë, muslimanët duronin vuajtjet nga bashkëqytetarët e tyre, në Siri ndodhnin betejat vendimtare mes dy superfuqive të atëherëshme, Bizantit dhe Persisë. Në atë luftë raskapitëse, persianët një kohë ishin të sukseshëm. Ky ishte një rast që idhujtarët mekas të provokojnë dhe t'i kërcënojnë muslimanët me humbje siç, humbën bizantinët nga adhuruesit e zjarrit. Megjithatë, Kurani i siguroi muslimanët se persianët kanë fituar vetëm një betejë dhe bizantinët së shpejti do t'ua kthejnë. (30: 1-6). Muslimanët luteshin për atë fitore dhe kur krishterët vërtetë fituan disa vite më vonë, muslimanët iu gëzuan suksesit të bashkësisë të cilën e konsideronin të afërtr me ta, siç edhe Kur'ani i përshkruan të krishterët.[17]

Njëra nga ngjarjet më madhështore në të gjithë historinë muslimane është emigrimi i muslimanëve të parë nga Meka në Medine. Prej të fundëve që emigruan ishte Muhamedi a.s dhe shoku i tij, më i mirë, Ebu Bekri. Në këtë ngjarje për ne lidhen dy detaje interesante. Në fakt, edhe krahas arniqësisë së madhe që idhujtarët e Mekës ushqenin ndaj Muhamedit a.s shumë prej tyre ia jepnin atij gjërat me vlerë (paratë) që kishin, sepse kishin besim të plotë tek ai. Në kohën kur nuk ka pasur banka, një person i tillë vlente shumë. Në momentin që nga frika për jetën e tij vendosi të largohet nga qyteti i lindjes, nën mbulojën e natës, i Dërguari i Zotit e dinte se kishte edhe një obligim ndaj atyre që kishin besim tek ai. Pas tij e la djalin e xhaxhait të tij Aliun t'i kthej gjërat e besuara tek pronarët e tyre. Mesazhi i këtij veprimi është shumë i qartë: e drejta e pronës është e shenjtë, fjala qoftë edhe për njerëzit e një feje tjetër dhe armiq të mundshëm.[18]

Një detaj tjetër që na intereson është udhërefyesi i Muhamedit a.s në këtë udhëtim. Siç edhe kishin dëgjuar për urdhërin e parisë mekase që Muhamedi a.s duhet të vritet me çdo kusht para se ta lëshojë qytetin, ai dhe shoku i tij duhej të lëviznin pa lënë shenja të gjurmëve. Për të arritur në vendin e caktuar ata kishin nevojë për një urdhërrefyes shumë të mirë. E gjetën tek një

idhujtarë mekas, Abdullah ibn Urejkit. Dallimi në fe nuk ishte pengesë për të dërguarin e Zotit që fatin e tij dhe të misionit të tij ta lë në duart e një njeriu, të cilit i besonte edhe pse predikonte se besimi i tij është në humbje.[19]

Në një kohë kur feja merrej me shumë seriozitet se sa sot, shfaqja e një lëvizje të reja fetare ka tërhequr vëmendjen. Kështu, selia e re e të Dërguarit të Allahut s.a.s, Medina, u bë destinacioni ku vinin delegacione të ndryshme nga e gjithë Arabia për t'u informuar për fuqinë e re ideologjike dhe politike. Në mesin e atyre delegacioneve ishte edhe një delegacion i krishterë nga jugu, nga Nexhrani[10]. Pas disa ditësh qëndrimi në xhaminë e Pejgamberit dhe diksutimit me të dhe shokët e tij ata qëndrojnë fortë në besimin e tyre. Para se ta lëshonin qytetin kërkuan që të kryejnë lutjen e tyre në xhami. Disa prej shokëve të Muhamedit a.s. kjo iu duk e papranueshe. Mirëpo, kështu nuk mendoi i Dërguari a.s. i cili intervenoi dhe lejoi delegacionin të kryej lutjen në xhaminë e tij, në vendin e dytë më të shenjtë në Islam.[20]

I Dërguari i Zotit e respektonte çdo qenie njerëzore pa marrë parasysh fenë. Kur gjatë një rasti u ngrit në këmbë nga respekti i një funerali hebrej i cili ishte duke kaluar, i thanë se ajo është një funeral hebrej në çka ai ua ktheu: mbi të gjitha, a nuk është shpirt njeriu?

Këtu mund të përmendim edhe shumë raste të bashkëpunimit dhe ndërveprimit të Muhamedit a. me jomuslimanët. Rasti i marrjes dhe dhënies së dhuratave të tyre; caktimi i një donacioni vjetor për një familje hebreje në Medine[21]; ndarja e mishit të therrur me fqinjët hebrej, paratë e huazuara nga jomuslimanët[23]; bërja e marëveshjeve me hebrejtë në Medine, me idhujtarët në Hudejbijë dhe me fisin Beni Hudha; e angazhoi jomuslimanin Ibn Ebi Hadradin të kontrollojë dhe vëzhgojë ushrinë e armikut nga fisi Thekif[24], dhe kështu me radhë.

Të edukuar nga fryma profetike e Muhamedit a.s. edhe muslimanët e tjerë nuk kanë hezituar të ndërtojnë marrëdhëniet me jomuslimanët. Kështu Ummu Seleme, me vonë njëra nga gratë e Muhamedit a.s., gjatë një udhëtimi për në Medine me djalin e saj që shkurorëzuar nga burri i saj. Osman b. Talha, një jo musliman, i ofroi që ta shoqëroj për shkaqe sigurie për çka ajo pranoi. Më vonë Ummu Seleme shpesh e përmendte rrëfimin dhe gjithmonë lavdëronte nderin dhe dëlirësinë e Othmanit.[25]

Duke iu falënderuar, para se gjithash, trashëgimisë profetike, muslimanët në trashëgiminë botërore përçojnë traditën e bashkëjetesës me të tjerët. Ka shumë vende muslimane me një numër të konsiderueshëm të pakicave jomuslimane ndërsa rreth një e treta e muslimanëve jetojnë sikur pakica fetare. Muslimanët boshnjak (ballkanas) edhe më tej dëshirojnë të zhvillojnë këtë traditë me të gjithë ata që e duan të njëjtën. Fqinjëve tanë dëshirojmë t'u tregojmë edhe njëherë se ky përkushtim i yni nuk është rezultat i pragmatizmit politik por një bindje e thellë se diversiteti në botë është dëshirë e Zotit. Muslimanët boshnjak besojnë se Zotit nuk i pengon pluralizmi fetarë boshnjak. Përkundrazi, besojmë se Zoti i Madhërishëm na inkurajon neve që të jemi të mirë për fqinjët dhe bashkëqytetarët. *“Allahu nuk ju ndalon të silleni mirë dhe të jeni të drejtë ndaj atyre që nuk luftojnë kundër jush për shkak të fesë dhe që nuk ju dëbojnë prej shtëpive tuaja. Me të vërtetë Allahu i do të drejtët.”* (60:8)

Ne e kuptojmë se Zoti ynë dëshiron që dallimet tona të na inkurajojnë të garojmë për të mirë, ndërsa Ai do ta jap vendimin përfundimtar mes neve dhe për këtë nuk kemi arsye që ne ta gjukojmë njëri-tjetrin për këtë, thjeshtë nuk kemi mandat. *“...Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provoj në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara në punë të mira! Të gjithë do të ktheheni tek Allahu e Ai do t'ju ;ajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti.”* (5: 48). [26]

Përktheu nga boshnjakishtja:
Mehas Alija

-
- [1] Për më tepër mbi historinë e dialogut ndërfeetar, shih: Muhammad Shafiq i Mohammed Abu-Nimer, *Interfaith Dialogue: A Guide for Muslims*, Washington, IIIT, 2007, 3-6; Eric J. Sharpe, „Dialogue of religions“, Mircea Eliade, ed., *The Encyclopedia of Religion*, New York: Macmillan, 1987, vol. 4: 344-48.
- [2] Shafiq i Abu-Nimer, viii-ix, v, 1.
- [3] Shafiq i Abu-Nimer, 1-3.
- [4] Shafiq i Abu-Nimer, 17.
- [5] Shafiq i Abu-Nimer, 42.
- [6] Kur'an, 25: 63.
- [7] El-Qarafi, *El-Furuq*, 3: 15 në Jusuf El-Karadavi, *Gajru 'l-muslimin fi 'l-mudžteme'i 'l-islami* (Bejrut: Muessesetu 'r-risale, 1985), 38.
- [8] Për më shumë komente të disa ajetëve të Kur'anit, shih: Tariq Ramadan, *Muslimanët euro-amerikanë dhe e ardhmja e Islamit*, Sarajevë, Shoqata Ilmijje, BI në BeH, 2007, 256-61.
- [9] Besimi i fortë i Talutit / Saulit dhe të atyre të cilët qëndruan pranë tij (2: 249); etj. Shih më shumë: Vidi Shafiq i Abu-Nimer, iv.
- [10] Shumë norma të zhvilluara për ngritjen e raporteve midis hebrenjve dhe të krishterëve, më vonë, u zgjeruan edhe ndërmjet hinduistëve, budistëve dhe grupeve të tjera fetare, me të cilët ranë në kontakt muslimanët. Megjithatë, kjo nuk ndodhi me dispozitat që kanë të bëjnë me martesën dhe ushqimin.
- [11] Tariq Ramadan, *In the Footsteps of the Prophet*, Neë York, Oxford University Press, 2007, 30.
- [12] Ramadan, 59-62.
- [13] Ai vit në historinë islame quhet Viti i Hidhërimit. Mirëpo, që këtu nuk është fjala për atë lidhje farefisnore, por atë lidhje të përgjithshme njerëzore më së miri na flet fakti se njëri prej xhaxhallarëve të të dërguarit zgjodhi të jetë armiku më i madh i tij për shkakun e të cilit e meritoi të jetë nga njerëzit e rrallë që përmend Kurani dhe që nuk janë të dërguar. Gjithësesi në kontesktin më të shëmtuar të mundshëm: "Iu thafshin duart Ebu Lehebit dhe u thaftë në gjithcka thotë kur'ani.
- [14] Ramadan, 68-70.
- [15] Shafiq and Abu-Nimer, 54 (Buhari, Kitab al-Khumus, kapitulli për lirimin e robërve..., hadithi nr. 3139).
- [16] Shafiq and Abu-Nimer, 65 (Buhari, 4547).
- [17] Shafiq i Abu-Nimer, 66-67; Kur'an, 5: 82
- [18] Edhe ajo që nga frika e lëshoi qytetin e tij vetëm pse kishte bindje të ndryshme, Muhamedi nuk e shfrytëzoi këtë si justifikim për të marrë gjërrat e të tjerëve. Për shkak të skeptikëve parashtrijmë një pyetje hipotetike, vallë, nëse e gjithë kjo nuk është e argumentuar historikisht dhe nuk është e vërtetë? edhe pse nuk ka arsyeje që të dyshojmë në vërtetësinë e ngjarrjes, edhe nën këtë supozim kjo episodë të cilën e regjistrojnë burimet islame ka vlerën e saj. Në fakt, mesazhi edukues i saj për gjeneratat e mëvonshme muslimane mbetet ende.
- [19] Shafiq i Abu-Nimer, 54.

[20] Sipas Tarik Ramadanit, i cili thirret tek Ibn Hishami, delegacioni numëronte 14 persona dhe ka ndodhur para luftës së Bedrit apo mes Bedrit dhe Uhudit. Sipas: Shafiq i Abu-Nimeru (Mubarekfuri, Nektari i vulosur i xhenetit, 411) delegacioni ka pasur 60 anëtarë dhe ka ndodhur në vitin e 9 h.

[21] Ramadan, 114-17; Shafiq i Abu-Nimer, 70; (Ibn Hişam, *Es-Sire en-nebevijje*, Bejrut: Dar u'l-džil, n.d., 2: 114).

[22] Shafiq i Abu-Nimer, 55, prema Karadavi, *Hallalli dhe harami*, Kapitulli 5

[23] Buhari, Kitabu 'l-buju', 1963

[24] Shafiq i Abu-Nimer, 54.

[25] Ramadan, 77.

[26] Autori e falënderon muftiun ushtarak në pranimin e ftesës që të prezentoj në punën e seminarit të Forcave ushtarake të BeH, të mbajtur në tetorë të vitit 2008, me ç'rast u përpilua edhe ky punim.